



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË

Himarë , më 06.12.2022

Lënda: Kthim përgjigjeje të kërkesës suaj për informacion në platformën elektronike E-mail datë 22.11.2022.

Znj._____

Në përgjigje të kërkesës suaj të datës 22.11.2022 ardhur me postë elektronike (e-mail) , ku kërkohet “Kërkesë për informacion” pranë Bashkisë Himarë.

Për sa më sipër po ju përgjigjemi pyetjeve sipas renditjes së bërë në kërkesën tuaj:

1. Gjendja aktuale e atij segmenti rrugor.

Segmenti Borsh-Kalaja është e asfaltuar, Kala-Ftrerre rrugë pa asfalt dhe e mirembajtur, Ftrerrë Kuç është jo funksionale.

2. Detyrimet ligjore të Bashkisë Himarë për mirëmbajtjen dhe zhblokimin e rrugës nga rrëshqitjet e dherave kur ndodhin të tilla.

Mirëmbajtja kryhet sistematikisht nga Bashkia Himarë në segmentin Borsh- Ftrerrë si nga rrëshqitjet e dherave dhe çdo problematik që haset.

3. Sa fonde janë parashikuar e planifikuar për mirëmbajtjen e saj për vitin 2023?

Fondi i parashikuar për mirëmbajtjen e rrugëve rurale për vitin 2023 është 15.000.000 lekë ku përfshihet dhe segmenti Borsh-Ftrerrë-Kuç.

4.Cila është perspektiva e atij segmenti rrugor për tu asfaltuar,me qëllim që edhe Fterra të lidhet me Bregdetin dhe rrugen e Lumit të Vlorës me rrugë të asfaltuar si gjithë fshatrat e tjerë të Bregut e të Kurveleshit.

Bashkia Himarë ka kërkuar dhe e ka në prioritet që kjo rrugë të shtrohet me asfalt duke kërkuar fonde si nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit por dhe te qeveria qendrore.

Ju falenderojmë për mirëkuptimin!

